



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:171378
Datë: 16.09.2024
Numri i dokumentit: 06164616

Ac.nr.6317/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, nga gjyqtarja individual Naime Ahmeti, në çështjen përmbartimore të kreditorit I.C.K. J.S.C. me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D.L.R. L.L.C., kundër debitorit D.Ç. nga Mitrovica, Rr. "...", me bazë juridike borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.907/22 të datës 12.08.2022, jashtë seancës me datë 16.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të kreditorit I.C.K. J.S.C. me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.907/22 të datës 12.08.2022, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.907/22 të datës 12.08.2022, në pikën një të dispozitivit ka aprovuar prapësimin e debitorit D.M.Ç., me adresë rruga "...", Komuna e Mitrovicës, ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.306/2021 të datës 22.06.2021. Në pikën dy, ka shfuqizuar urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.306/2021 të datës 22.06.2021, duke abroguar të gjitha veprimet e ndërmarra përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, të aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e kreditorit, të ndryshoj aktvendimin e atakuar duke e refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin si dhe të detyrohet debitorja në përmbushje të obligimit ndaj kreditorit.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorës në bazë të dokumentit përmbartues-kontratës mbi huan, dhe konfirmimin mbi regjistrimin e pengut R-20190902-258, të regjistruar pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë-Zyra për Regjistrimin e Pengut. Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin e kërkuar me urdhrin përmbartimor P.nr.306/21 të datës 21.06.2021, ndaj të cilit urdhër debitori ka paraqitur prapësim me datën 06.07.2021, ndërsa kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datën 06.07.2021. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimin dhe përgjigjes në prapësim vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë ka drejtë ka vepruar kur ka pranuar prapësimin e debitorit ngase sipas nenit 38 të LPP-së, parashihet se: *“Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit”*. Në rastin konkret me propozimin për përmbartim nuk janë paraqitur në origjinal apo në kopje të vërtetuar sipas ligjit konfirmimi për regjistrimin e pengut, i cili në këtë rast është dokument përmbartues andaj, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vepruar kur ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për lejimin e përmbartimit nga përmbartuesi privat.

Lidhur me pretendimin ankimor të kreditorit se gjykata nuk ka mundur të vendos sipas prapësimin duke u bazuar në nenin 38 të LPP-së, pasi që shkaqet e prapësimin janë paraparë me nenin 71 të LPP-së, Gjykata e Apelit vlerëson se është pretendim i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, për faktin se sipas nenit 43, paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se: *“...Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbartimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbartuesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbartim nga përmbartuesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*. Sipas shkresave të lëndës, rezulton se gjykata e shkallës së parë me rastin

e shqyrtimit të prapësimit ka vlerësuar se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarrim dhe me të drejtë ka shfuqizuar urdhrin përmbarrues. Në bazë të asaj që u tha më lartë aktvendim i gjykatës së shkallës së parë u deshtë që të vërtetohet dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6317/2022 me datë 16.09.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti